



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA**

---

**AD/GJTHPR/26/24**

**AUTORITETI KOMPETENT I GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË** - Kryetarja e Gjykatës Albina Shabani Rama, duke vendosur sipas ankesës disiplinore të parashtruar nga F.N, ndaj gjyqtarit S.S, bazuar në dispozitën e nenit 10 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, pas shikimit të shkresave dhe vlerësimit të ankesës, me datë 29.11.2024 merr këtë:

**V E N D I M**

**HUDHET** ankesa disiplinore e ushtruar nga F.N ndaj gjyqtarit S.S, për shkak të **parashkrimit të shkeljes disiplinore të supozuar.**

**A r s y e t i m**

Me datë 15.11.2024, Këshilli Gjyqësor i Kosovës duke vepruar konform nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë te autoritetit kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga F.N ndaj gjyqtarit S.S, me pretendimet se ju është bërë e padrejtë në nxjerrjen e vendimit P.nr.550/17, ku sipas saj ky vendim ka qenë definitiv gabim, është nënë me fëmijë dhe është maltretuar qe 11 vite psiqikisht, moralisht dhe financiarisht.

Me datë 19.11.2024, Kryetarja e Gjykatës duke vepruar në kuptim të nenit 9 paragrafi 5 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, e ka njoftuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës për pranimin e ankesës disiplinore të parashtruar nga F.N ndaj gjyqtarit S.S.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe shikimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Prokuroria Themelore në Prishtinë me datë 21.05.2015 ka ngritur aktakuzën PP.nr.II.nr.82/13 ndaj këtu ankueses F.N, ndërsa gjyqtari me datë 16.03.2017 ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në lidhje me këtë çështje, ndërsa me datë 20.03.2017 ka nxjerrë Aktgjykimin fajësues sipas të cilit e pandehura – këtu ankuesja është shpallur fajtores për veprën penale “Sulmi” nga neni 187 par. 1 të KPRK-së dhe është dënuar me dënim me burgim në afat prej 3(tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në çoftë se në afat prej 1(një) viti nuk kryen veprë penale të re. Ky vendim është bërë i plotfuqishëm me datë 03.01.2018.

Sipas dispozitës së nenit 10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, *Autoriteti Kompetent nuk kërkon fillimin e hetimeve si dhe Këshilli nuk fillon hetimet ndaj një gjyqtari apo prokurori për shkelje disiplinore në qoftë se kanë kaluar pesë (5) vjet nga koha e kryerjes së shkeljes së supozuar disiplinore.*

Në këtë drejtim, nga koha e përpilimit të Aktgjykimit P.nr.550/17 që është data 20.03.2017, a po nga koha e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi që është data 03.01.2018 e deri me datë 15.11.2024 kur e ankuesja ka parashtruar ankesë disiplinore, kanë kaluar më shumë se 5(pesë) vite nga shkelja disiplinore e supozuar, andaj Autoriteti Kompetent në bazë të nenit 10 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nuk mund të ndërmarrë veprime në drejtim të shqyrtimit të ankesës disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 10 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7 paragrafi 1 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/26/24, me datë 29.11.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë